



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: "TV KAMENICA" SH.P.K


Numri Unik identifikues: 810009614

Pronar: Burim Qehaja

Kandidati për licencë: "Kosovanet."

Platforma: Operator i Shpërndarjes sipas platformes Kabllore dhe IPTV

Adresa: Rr Skënderbeun p.n Kamenicë Kosovë



VEN D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, "Kosovanet", sipas platformave: Operator i Shpërndarjes sipas platformës Kabllore dhe IPTV, me seli në Kamenicë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2020/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati "Kosovanet" më datën 09 qershor 2023, ka aplikuar për licencë të KPM-së, për Operatorë të Shpërndarjes së ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale sipas platformës Kabllore, dhe IPTV

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja".

6. Komisioni, i ka ofruar kandidatit për licencë për operator të shpërndarjes “Kosovanet” të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2020/01) Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (Rregullorja KPM-2017/06) dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
7. Për shkak të mungesës së vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur të Mediave, nga data 15 tetor 2022 deri më datën 6 qershor 2023 si dhe grumbullimit të lëndëve, kërkesa e “Kosovanet”, nuk ka arritur të shqyrtohet me kohë.
8. Komisioni vlerëson se kandidati “Kosovanet” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për Operator të Shpërndarjes dhe IPTV në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2020/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
9. Me Rregulloren KPM-2020/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Komisioni e KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 5, 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2020/01, ndërsa, kandidati “Kosovanet” ka dorëzuar një listë prej 41 kanaleve, përfshirë edhe marrëveshjet për transmetimin e tyre të cilat janë të vërtetuara tek shoqata për verifikimin mbi të drejtat e autorit VAPIK .
10. Kandidati “Kosovanet” për Operator të Shpërndarjes sipas platformës Kabllore, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2020/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit të vërtetuara në VAPIK
11. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për Operator të Shpërndarjes “Kosovanet” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën e tij, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “Kosovanet” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato dhe vërtetuar në VAPIK.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati “Kosovanet” ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2020/01 si dhe me Rregulloren KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
13. Komisioni vlerëson se, kandidati për Operator të Shpërndarjes “Kosovanet”, ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

Vendim

14. Komisioni në takimin e datës 1 shtator 2023, merr vendim që kandidatit “Kosovanet” i cili planifikon të operojë në Komunën e Kamenicës, t’i lëshojë licencën e KPM-së për Operator të Shpërndarjes të Ofrueseve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale sipas platformës Kabllore dhe IPTV, për të ofruar shërbime të programeve, në pajtim me

katalogun e ofruar programor sipas marrëveshjeve për të drejtat autoriale të atyre shërbimeve mediale audiovizuale.

15. Në pajtim me Nenin 21, paragrafi 2 të Ligjit për KPM-në, licenca e Operatorit të Shpërndarjes Kosova Net do të jetë e vlefshme në një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes sipas Nenit 25 të këtij ligji.

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.09.2023

datë